



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:056492

Datë: 09.06.2022

Numri i dokumentit: 03115216

PKR.nr.78/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e Trupit Gjykues – Gjykatësi **Drilon Haraçia**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, kundër të akuzuarve M. H. nga fshati G. Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, i akuzuari Sh. E. nga fshti N., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër PP/I.nr.143/2022, të datës 27.05.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datën 09.06.2022**, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj – Hyseni, si dhe të akuzuarve dhe mbrojtësit së të akuzuarit të dytë av.Ali Uka, sipas autorizimit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

M. H., i lindur me në Gjakovë, me banim në fshatin G., Komuna e Rahovecit, nga i ati M. dhe e ëma R., e lindur M., beqar, ka të kryer shkollën mesme, punon si dixhej sezonal, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SH. E., i lindur me në fshtin N., Komuna e Rahovecit, ku edhe banon, nga i ati K. dhe e ëma Z., e lindur K., i martuar, at i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

I akuzuari M. H.

I. Sepse nga data 06.03.2022 deri me datë 08.03.2022, në shtëpinë e tij në fshatin G. K.Rahovec, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armë dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 Ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës, në atë

mënyre që pas një intervistimit rreth një rasti penal, i pandehuri kishte pohuar se në shtëpinë e tij në vendin e lartcekur posedonte 1 (një) armë pistoletë e tipit TT-Zastava, prodhim Yugoslllav, me numër serik, kalibër 7.62mm, 1 (një) karikatorë dhe 8 (tetë) fishekë kalibër 7.62mm, e cila më pas ishte konfiskuar nga ana e zyrtarëve policorë.

- **Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

I akuzuari Sh. E.

II.Sepse nga data e pa vërtetuar deri me datë 06.03.2022, në shtëpinë e tij në fshatin N., K.Rahovec, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armë dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 Ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyre që pasi të pandehurit M. e përshkruar si në pikën I të dispozitivit i ishte gjetur arma e tipit 1 (një) armë pistoletë e tipit TT-Zastava, prodhim Yugoslllav, me numër serik, kalibër 7.62mm, 1 (një) karikatorë dhe 8 (tetë) fishekë kalibër 7.62mm, i njëjti ka deklaruar se armën e kishte marrë nga i pandehuri Sh. E.-miku i tij, ky i fundit pranon se këtë armë e ka poseduar si kujtim nga babai.

- **Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe nenit 366 par.1 dhe 3 të KPRK-së, të akuzuarit i:

G J Y K O N

TË AKUZUARIN M. H.

ME DËNIMIN ME KUSHTË, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari M. H., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 € në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

TË AKUZUARIN SHKELZIM ELSHANI

ME DENIM ME GJOBË në shumë prej **500.00 € (pesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **25 (njëzetë e pesë) ditëve**, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 (njëzet) €uro.

Ndaj të akuzuarve konfiskohen: 1 (një) armë pistoletë e tipit TT-Zastava, prodhim Jugosllav, me numër serik 2-00-101, kalibër 7.62mm, 1 (një) karikatorë dhe 8 (tetë) fishekë kalibër 7.62mm, si objekte të veprës penale.

Detyrohet i akuzuari Sh. E., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 € në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.143/2022, të datës 27.05.2022, kundër të akuzuarve M. H. nga fshati G. Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, i akuzuari Sh. E. nga fshti N., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj - Hyseni, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit të cekur me lartë, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari M. H., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, shton se është penduar për veprën e kryer, i premtton gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla penale, duke i propozuar gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

I akuzuari Sh. E., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, shton se është penduar për veprën e kryer, i premtton gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla penale dhe më vie keq lidhur me këtë rast, duke i propozuar gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj Hyseni, duke dhënë mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarve, pasi që të njëjtit i kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat në të cilat mbështetet edhe aktakuza, i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. E., avokati Ali Uka nga Gjakova, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka deklaruar se i mbrojturi im në këtë shqyrtim fillestar pranojë fajësinë për veprën penale nga aktakuza dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me te, andaj i propozojë gjykatës që këtë pranim të fajësisë të bërë nga i mbrojturit tim ta aprovojë, dhe duke qenë se i mbrojturi im si në poli po ashtu edhe në prokurori e ka pranuar veprën penale nga akuza e po ashtu edhe në këtë shqyrtim fillestar i propozojmë gjykatën që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të njëjtin si rrethanë lehtësuese të merret për bazë pranimi i sinqertë nga ana e tij gjendjen e tij ekonomike të dobët, është mbajtës i vetëm i familjes, nuk ka qenë më parë i dënuar , i njëjti është penduar për veprën e kryer, dhe i njëjti premtion se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër të njëjtë apo të ngjashme penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, po ashtu i akuzuari i dytë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. Ali Uka, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari M. H. dhe Sh. E., me dashje kanë kryer veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 parg. 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjykata të akuzuarin M. H. dhe Sh. E., i ka shpallur fajtor sipas aktakuzës, ngase në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha

elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit M. H., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: kohe pas kohe punon DJ, jeton vetë i 3 në familje, mbajtës i familjes, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, gjendjen e tij ekonomike të dobët, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilat ngarkohet, faktin se është i gjendjes shumë të dobët ekonomike. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimeve nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Sh. E., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: kohe pas kohe punon si punëtor fizik dhe bujk, jeton vetë i 8 në familje, mbajtës i familjes, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, gjendjen e tij ekonomike të mesme, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilat ngarkohet. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimeve nga neni 38 dhe 43 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi

Gjykata ndaj të akuzuarve konform neneve 366 par. 3 të KPRK-së, ka marr vendim për konfiskimin 1 (një) armë pistoletë e tipit TT- Zastava, prodhim jugosllav, me numër serik,

kalibër 7.62mm, 1 (një) karikatorë dhe 8 (tetë) fishekë kalibër 7.62mm, si objekte të veprës penale.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.78/22, me datë 09.06.2022

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.